




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 16, datë 25.02.2020.

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Vau-Dejës, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e **z.Nikoll Zef Prela** banore i fshatit Rranxa të Njësisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës banesa e të cilit është dëmtuar nga tërmeti i dt.28.01.2020 nga Buxheti i Bashkisë i vitit 2020 si dhe Buxheti i Vitit 2020 në Ministrinë e mbrojtjes, programi “Mbrojtja Civile”
Shkak i dëmtimit të kësaj shtëpie është dëmtimi nga tërmeti, e vlerësuar nga specialistet e grupit të punës.

Baza Ligjore

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji për prefektin Nr.107/2018, Ligji nr.45/2019 “për mbrojtjen Civile, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimit Nr.3 datë 28.12.2016 i KM “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016 ,në shkresën **Nr. 287 prot, datë 14.02.2017** të Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të banesave (drejtoria teknike) dërguar Këshillit të Qarkut Shkodër për çmimet për zëra punimesh të vitit 2016, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.92 dt.24.12.2019 mbi “Miratimin e Buxhetit të Vitit 2020”.

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e familjes së shtetasit **Nikoll Zef Prela** banorë i Bashkisë Vau-Dejës për mbështetje financiare të tij, për dëmtimin e banesës së tij nga tërmeti me dt.28.01.2020.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau-Dejës.